



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2026

PROÇES VERBAL

**MBI VERIFIKIMIN E DOKUMENTACIONIT TË PARAQITUR NGA APLIKANTËT
PËR VENDIN VAKANT TË SHPALLUR NË DATËN 05.03.2026 NË FAQEN
ZYRTARE TË AMVV**

Bazuar në rregulloren e brendshme të AMVV, neni 14 pika 14/7/a për procedurat e pranimit në punë, si dhe në manualin për “Përcaktimin e rregullave, kriterëve dhe procedurave për shpalljen vendeve vakante në administratën e AMVV-së”, mbahet ky proces verbal sot, datë 24.03.2026 nga komisioni i ngritur me urdhër nr.24, datë 05.03.2026, protokolluar me nr. 138/1.prot, për procedurat e pranimit në pozicionin vakant, dhe për të verifikuar dokumentacionin e paraqitur nga aplikantët në zyrën e protokollit të AMVV-së, për pozicionet të shpallur në faqen zyrtare më 05.03.2026.

I. DOKUMENTACIONI PËR APLIKIM DHE SHQYRTIMI NGA KOMISIONI

Punëmarrësi është i detyruar t'i paraqesë Punëdhënësit dokumentet e mëposhtme:

- a) dokumentin e identitetit, (fotokopje);
- b) curriculum vitae,(CV);
- c) librezën e punës;
- d) dëshmi penaliteti;
- e) kërkesë e motivuar;
- f) fotokopje të noterizuar të diplomës.

Komisioni pasi bëri verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga aplikantët dhe verifikoi kërkesat e mëposhtme:

- Të jetë shtetas Shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;

- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore, që nuk është shuar sipas këtij ligji;
- Të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, përvojës dhe kërkesat e tjera të posaçme për kategorinë, klasën, grupin dhe pozicionin përkatës;
- Të zotëroj gjuhën Angleze të folur dhe të shkruar.

II. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Komisioni njofton për vazhdimin e konkurrimit në fazën e dytë të intervistimit të kandidatëve me gojë.

Për vendin vakant “Përgjegjës” në Sektorin e Performancës, në Drejtorinë e Statistikës dhe Performancës, 1 pozicion. Klasa e pages III-2, kanë paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin e kërkuar pranë protokollit të institucionit aplikantët:

1. Z.Etis Jareci;
2. Znj.Xhanina Llango.

III. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

1. Vendimi nr 227 datë 9.4.2024 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Veteqeverisjes Vendore” ([Vendimi-227-date-9.4.2024-Per-organizimin-dhe-funksionimin-e-agjencise-per-mbeshtetjen-e-veteqeverisjes-vendor.pdf](#));
2. Ligji nr 139 date 17.12.2015 “Për veteqeverisjen vendore” (<https://qeverisjavendore.gov.al/wp-content/uploads/2024/08/Ligji-nr.-139-date-17.12.2015-Per-veteqeverisjen-vendore.pdf>);
3. Rregullore e Brendshme e AMVV (<https://qeverisjavendore.gov.al/wp-content/uploads/2025/06/rregullorja-e-re-AMVV-17.06.2025.pdf>);
4. Raporti vjetor i AMVV, 2024 (https://qeverisjavendore.gov.al/wp-content/uploads/2025/03/Raporti-vjetor_AMVV_-2024_FINAL-1-1.pdf);
5. Njohuri mbi detyrat e sektorit të performancës:
 - a. Raporti vjetor i Sistemit të Matjes së Performancës (<https://qeverisjavendore.gov.al/wp-content/uploads/2025/11/SMP-2024.pdf>),
 - b. Metodologjia e SMP (<https://qeverisjavendore.gov.al/perfomanca-dhe-qeverisja-e-mire/raporte/smp-2025/>)
 - c. Udhëzimi i Përbashkët nr 01 datë 11.07.2025 (<https://qeverisjavendore.gov.al/wp-content/uploads/2025/07/Udhezim-i-perbashket-MF-MSHPV-granti-i-performances.pdf>)

Bulevardi Zhan d’Ark, IshShtëpia e Ushtarakëve, Kati VII, Tiranë – Shqipëri

- d. Mekanizmi i Grantit bazuar në Performancë
<https://qeverisjavevendore.gov.al/perfomanca-dhe-qeverisja-e-mire/granti-i-bazuar-ne-performance/rreth-grantit/>).

IV. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është **30 pikë**.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi fushën e njohurive, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b) Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c) Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është **70 pikë**.

V. NJOFTIMI I INTERVISTËS ME GOJË

Intervista do të zhvillohet ditën e premte, datë 27.03.2026 në adresën; Rruga “Mustafa Matohiti”, Godina nr 4, përbri Shkollës 9-vjecare “Kosova”, Tiranë.

Për pozicionin vakant “Përgjegjës” do të zhvillohet intervista në ora 10:00.

Aplikantët do të njoftohen me email në adresat e tyre të dorëzuara.

KOMISIONI

Gersi Çabiri

Olta Caca

Erlisa Labi